

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
 ODLIKA JE PRAVNO-SNAŽNA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I UROSEVAC

NË EMËR TË POPULLIT

Më
 Data 16.05.2017

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITSHËM
 DIVIZIONI PENAL**, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin individual Mustaf Tahiri si dhe me sekretaren juridike Drita Ujupi, në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDACTED], për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1313-5/14 të datës 26.08.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit të hapura gjyqësor me datë 17.01.2017, mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 01.02.2017 përpiloi me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari: [REDACTED], nga Ferizaj rr. [REDACTED] (afër tregut), i lindur më [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] i martuar, prind i pesë fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal [REDACTED]

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 11.11.2014, në lokalin e tij në rr. [REDACTED] në Ferizaj, me rastin e kontrollit nga ana e punëtorëve të paautorizuar të KEDS-i, Qendra e Kalibrimit në Prishtinë, kanë konstatuar se konsumatori me qëllim të përvetësimit të pasurisë së huaj të luajtshme e që vetes të i sjell dobi pasurore të kundërligjshme, e ka keqpërdorur energjinë elektrike në atë mënyrë që njehsori elektrik numër 4748022, pllombat shtetërore i ka të falsifikuara, numëruesi i njehsorit është i manipuluar, ka gjurmë të gërvishjes së numrave në numrator shifra e tretë nr.3.4, shifra e katërt nr.4.5, shifra e pestë nr 1.2 në T1, nga ana e jashtme njehsori dëmtime të tjera nuk ka, ku me këtë i ka shkaktuar dëm KEDS-it në shumën prej 496.94€,

- me të cilën kreu veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së lartë përmendur dhe nen. 4,7,17,23,41,42.43,45,46,49,50,51,52 dhe 73 të KPK-së dhe nenit 365 të KPPK-së të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Me të cilin e gjykon me dënim me gjobë në lartësi prej 300 (treqind) euro si dhe dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj dhe në të njëjtën kohë urdhëron që dënimi me gjobë dhe dënimi me burgim të mos ekzekutohen nëse i akuzuari në kohën prej 1 /një/ viti pasi ky aktgjykim të marrë formën e prerë nuk do të kryej veprën tjetër penale.

Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës KEK-u në Ferizaj, t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar në shumën prej 496.94€.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzjetë/€, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

Ar sy e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP.nr.1313-5/13 të dt.26.08.2014 e ka ngarkuar të pandehurit [REDAKTUAR] nga Ferizaj për veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Duke vepruar në këtë çështje penale gjykata mbajti shqyrtimin gjyqësor, në të cilën përfaqësuesi i akuzës - prokurori i shtetit në fillim të shqyrtimit gjyqësor lexoi aktin akuzues, ndërsa në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit mbeti në tërësi pranë aktit dhe kualifikimit juridik të tij, duke kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtorë dhe ti përcaktohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Të akuzuarit [REDAKTUAR] konform neni 325 të KPPK-së në shqyrtimin gjyqësor i është dhënë mundësia për tu deklaruar lidhur me fajësinë, ku i njëjti ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale me të cilat ngarkohet, i cili në mbrojtjen e tij ka deklaruar lidhur me këtë çështje për të cilën akuzohem nuk ka të bëjë fare me mua, pasi që njehsori elektrik nuk është i imi dhe se unë posedoj dy njehsor në emrin tim dhe atë njerin në shtëpinë e tij ku banon në rrugën [REDAKTUAR] dhe njerin në lokalin e tij që gjendet në rrugën [REDAKTUAR] dhe se njehsori elektrik për të cilën po akuzohem është ndëruar në vitin 2009 e cila orë është aktivizuar diku por nuk e di se ku është duke punuar por evidentohet në emrin tim dhe se nuk ka asnjë të dhënë timen dhe se besoj që është duke punuar në ndonjë lokal dhe i njëjti figuron borxh diku 2700€. I njëjti ka deklaruar se ka një lokal në rrugën [REDAKTUAR] por se ky lokal në vitin 2014 ka qenë i mbyllur dhe aty nuk ka punuar askush.

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të këtij vlerësimi vërtetohet gjendjen e fakteve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen faktike gjykata e vërtetoi nga dëshmia e dëshmitarit [REDAKTUAR] i cili në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se si punëtor i qendrës së kalibrimit, ka marrë pjesë në procesin e kalibrimit me rastin e kontrollit detaj të njehsorit elektrik me numër 4748022 dhe se gjatë kontrollit kanë konstatuar se njehsori elektrik bllobat shtetërore i ka të falsifikuara dëmtime të jashtme nuk ka po është konstatuar se numëruesi i njehsorit është manipuluar ka gërvishje në shifrën e tretë nr. 3 dhe 4, shifrën e katërt nr.4 dhe 5, shifrën e pestë nr.1 dhe 2 në T1.

Po ashtu nga dëshmia e dëshmitarit [REDAKTUAR] i cili në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se ka qenë anëtare e komisionit të kontrollit –kalibrimit të njehsorit elektrik me nr.4748022 i cili njehsor ka ardhur në Qendrën e Kalibrimit në Prishtinë nga distrikti i

Ferizajt pa emër dhe pa mbiemër pa shifër të konsumatorit vetëm në të dhëna teknike dhe është kërkuar kontrollimi detal dhe pas kontrollit është konstatuar se njehsori elektrik viti i prodhimit 2007 bllobat shtetërore i ka të falsifikuara dhe se bllobat i ka pasur të vitit 2006. Nga ana e jashtme njehsori elektrik dëmtime nuk ka pasur ndërsa në mbendi numruesi ka pasur manipulime në shifrën e tretë nr. 3 dhe 4, në shifrën e katërt nr. 4 dhe 5 dhe në shifrën e pestë nr 1 dhe 2 në T1 dhe se manipulimi është bërë me qëllim që energjia elektrike e shpenzuar të çregjistrohet. Pas kontrollit të njejtin njehsor e kemi bllobuar me bllobë distribuive C400071897 dhe të njejtin e kemi kthyer në distriktin e Ferizajt.

Gjykata gjendjen faktike e ka vërtetuar edhe dëshmia e dëshmitarit [REDAKTUAR] i propozuar nga i akuzuari, i cili në dëshminë e tij se në bazë të faturës se KEK-ut në emër të [REDAKTUAR] dhe me shifër 9024458, së bashku me kolegun e tij [REDAKTUAR] kanë dalë në teren dhe e kanë përpiluar procesverbalin i cili gjendet në shkresat e lëndës, i njejtin ka deklaruar se nuk e kanë takuar të akuzuarin [REDAKTUAR] dhe asnjë nga familja e tij dhe se nuk kanë pasur qasje tek njehsori i konsumatorit, ndërsa nuk i kujtohet se ku gjendet saktësisht ky objekt pasi që ka kaluar një kohë e gjatë dhe për shkak të shumë kontrollave dhe verifikimeve që kanë pasur në teren nuk i kujtohet saktë.

Gjithashtu gjendjen faktike e ka vërtetuar edhe dëshmia e dëshmitarit [REDAKTUAR] i propozuar nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se nuk e din saktë se kur punëtorët e KEDS-it i kanë hequr të akuzuarit njehsorin nga shtëpia e tij, duke shtuar se me rastin e përpilimit të procesverbalit me nr.0777290 të dt.23.12.2013 e ka përpiluar së bashku me kolegun e tij [REDAKTUAR] dhe se numri i tij i punës është 6749. Dëshmitari gjithashtu ka deklaruar se këtë procesverbal e kanë përpiluar për shkak se në bazë të procesverbalit të Qendrës së Kalibrimit në Prishtinë ka rezultuar se njehsori elektrik i të akuzuarit ka qenë i manipuluar dhe në bazë të rregulloreve të mbrendshme kemi përpiluar procesverbal pa prezencën e të pandehurit dhe pa bërë identifikimin e pajisjeve elektrike për shkak se lokali ka qenë i mbyllur dhe nuk kemi pasur qasje në të.

Gjykata dëshmitë e dëshmitareve [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] i ka vlerësuar si të besueshme, objektive dhe reale, pasi që të njëjtat gjejnë mbështetje edhe në provat tjera materiale siq janë procesverbali i kalibrimit nga Departamenti i Matjes Elektrike Sektori Qendra e Kalibrimit nr.2048 datë 14.11.2013, procesverbali KEDS nr.0777290 dt.23.12.2013, fatura DFE13HP08344 e dt.361.12.2013 si dhe fotografitë dhe shkresat tjera të lëndës.

Gjykata gjithashtu vlerësoi edhe e mori në konsideratë edhe mbrojtjen e të akuzuarit, mirëpo gjykata një mbrojtjes së tillë nuk e vlerësoi si të besueshme, sepse mbrojtja e të pandehurit është kontradiktore, nuk është e mbështetur në prova dhe fakte, por më shumë është e orientuar nga fshehja e veprimeve inkriminuese me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së të kryer në kohën, në mënyrën dhe rrethanat e përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me datën 11.11.2014, në lokalitë e tij në rr. [REDAKTUAR] në Ferizaj, me rastin e kontrollit

nga ana e punëtorëve të paautorizuar të KEDS-i, Qendra e Kalibrimit në Prishtinë, kanë konstatuar se konsumatori me qëllim të përvetësimit të pasurisë së huaj të luajtshme e që vetes të i sjell dobi pasurore të kundërligjshme, e ka keqpërdorur energjinë elektrike në atë mënyrë që njëhsori elektrik numër 4748022, pllombat shtetërore i ka të falsifikuara, numëruesi i njëhsorit është i manipuluar, ka gjurmë të gërvishjes së numrave në numrator shifra e tretë nr.3.4, shifra e katërt nr.4.5, shifra e pestë nr 1.2 në T1, nga ana e jashtme njëhsori dëmtime të tjera nuk ka, ku me këtë i ka shkaktuar dëm KEDS-it në shumën prej 496.94€.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neni 73 të KPRK-së ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata të akuzuarit si rrethana lehtësuese i mori parasysh faktin se nuk ka të dhëna se i akuzuari më parë ka qenë i dënuar për ndonjë veprë penale, se është i martuar dhe baba i katër fëmijëve, e në mungesë të rrethanave rënduese vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale dhe rezikshmerinë konkrete të veprës penale duke i shqiptuar dënim të kushtëzuar si në dispozitiv të aktgjykimit me bindjen se një dënim i tillë është plotësisht i justifikueshëm dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale me bindje se me këtë lloj të dënimit, do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës KEK-u në Ferizaj, t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar në shumën prej 496.94€.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 /tridhjetë/€, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
P. nr. 910/14, dt. 01.02.2017

Sek.juridike
Drita Ejupi

Gjyqtari,
Mustaf Tahiri



KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.